



## REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

A.nr.1900/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtare, Lirije Maksutaj e me sekretaren juridike Kaltrin Çitaku, në konfliktin administrativ të paditëses, D.S.e lindur në S. me vendbanim në P. të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Av. B.J. nga , P. të paditurës, Ministria e Punëve të Brendshme-Komisioni i Ankesave për Shtetësi në Prishtinë (MPB-KASH), për shkak të anulimit vendimit, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur me dt.04.10.2018, merr këtë,

### A K T G J Y K I M

**I. Aprovohet** si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit D.S.ndërsa **Anulohet** vendimi i të paditurës, Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës-Komisioni i Ankesave për Shtetësi në Prishtinë i datës 18.12.2012 dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

**II. Obligohet** e paditura MPB nga pikëpamja juridike e kësaj gjykate si dhe nga vërejtjet e dhëna lidhur me procedurën.

### A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në prezencën e paditësit dhe përfaqësuesit të saj e në mungesë të paditurës e ftuar më mënyrë të rregullt.

Paditësi si në padinë e parashtruar me dt.24.02.2014 të ushtruar pranë kësaj gjykate por edhe në fjalën përfundimtare të dhënë në seancën e shqyrtimit kryesor, përmes përfaqësueses së saj ka deklaruar se mbetemi në tersi si në padi dhe kërkesë padi. Pala paditëse konsideron se me aktvendimin e gjykatës se Apelit A.A.nr.549/17 të dt. 04.07.2018, është aprovuar ankesa e paditëses e lindur në S. të T., me të cilën e ka krijuar bazën juridike që paditëses në këtë procedure të rigjykimit ti njihet e drejta e shtëpisë e Republikës së Kosovës mbi bazën e Ligjit të Shtetësisë me natyralizim, mbi lidhjet të pjesëtarit të diasporës marr për bazë që paditësja kishte arritur të siguronte dokumentacionin e nevojshëm sipas dispozitave të ligjit të lartë përmendur, siç e ka theksuar edhe vet aktvendimi i shkallës së dytë me nenin 13.3 i cili thekson se: Pjesëtari i diasporës konsiderohet edhe secili person i cili është pasardhës brenda një gjenerate i personit të përmendur në par.2 të këtij neni dhe i cili dëshmon se mbanë lidhje familjare në Republikën e Kosovës. Paditësja në procedurën e zhvilluar ka dëshmuar se prindi i saj ka qenë i lindur dhe ka qenë nga P. dhe shtetas i RK, ashtu që ka edhe një adresë të saktë në qytetin e P. dhe në bazë të saj kërkesa e saj për shtetasin e Kosovës duhet të konsiderohet legjitime dhe e bazuar me ligje. I ka propozuar gjykatës që kërkesën e paditëses për marrjen e shtetësisë ta aprovoj të bazuar.

Përfaqësuesja e autorizuar e të paditurës në përgjigjen në padi të datës 15.06.2017 e dhënë me shkrim gjykatës si dhe me parashtrësën e datës 04.10.2018 ka kundërshtar pretendimet e paditësit si të pabazuara duke kërkuar nga gjykata që të marrë aktgjykim me të cilën refuzon kërkesë padinë e paditësit në tërësi si të pa bazuar duke lënë në fuqi vendimin e të paditurës.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.04.10.2018, ka bërë administrimin e provave dhe atë: aktvendimi i të paditurës dt. 18.12.2012, ankesë e dt. 31.05.13, procesverbali i seancës kryesore të komisionit për shtetësi nr. 3758/12, vendimi i komisionit për shtetësi 18.12.12, certifikatë me nr. ..., certifikatë me numër ... dt. 19.11.12, vërtetim me nr. 6963/12 dt. 21.11.12, vërtetim nga QPS nr. 21-2089 i dt. 19.11.12 P., letërnjoftim i dt. 05.11.12, subjekti apostile i dt. 05.11.12, vërtetim i MPB dt. 20.11.12, certifikatë dt. ... Gjykata Komunale Prizren, letërnjoftim për nënën e paditëses S.Z., fotokopje e pasaportës së paditëses, certifikatë e shtetësisë për nënën e paditëses, certifikata e vendbanimit për S.Z. dt. 03.10.12, certifikatë e lindjes për paditësen me shkresat përcjellëse, deklarata për betimin për paditësen, aplikacioni për kërkesën e paditëses dt. 21.11.12, certifikatë e martesës për prindërit e paditëses, përgjigjja e të paditurës dt. 19.06.17, parashtrësia e dt. 04.09.17 me shkresat tjera dhe aktgjykimi A.A.nr.549/17 dt.04.07.2018, parashtrësia e dt.04.10.2018.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadija e paditëses është e bazuar.

Me vendimin e të paditurës të datës 18.12.2012 ankuesit i është refuzuar ankesa si e pabazuar, duke lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë.

Nga vendimi i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla, për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 par. 2 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 85 të po të njëjtë ligj, parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtat dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen çartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i pa çartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se D.S. nga P. nuk i ka përmbushur të gjitha kushtet me nenin 13 par.13.2 dhe 13.3 të Ligjit për Shtetësinë e Kosovës nr.03/L-034 si dhe Udhëzimit Administrativ nr.17/2009-MPB për Procedurat e fitimit të Shtetësisë së Kosovës, andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës si rezultat i të gjykuarit të tërësisht konstatohet që kërkesa nuk është e bazuar.

Gjykata vëren se e paditura në arsyetimin e vendimit kontestues vetëm ka bërë citimin e nenin 13 par.13.2 dhe 13.3 të Ligjit për Shtetësinë e Kosovës nr.03/L-034 si dhe Udhëzimit Administrativ nr.17/2009-MPB për Procedurat e fitimit të Shtetësisë së Kosovës, pa dhanë ndonjë arsyetim ta bazuar në lidhje me pretendimet e kërkesës sa i përket fakteve dhe prova të bashkangjitura në shkresat e lëndës. Fakti se nga akti i kontestuar i të paditurës nuk dihet cilat janë ato fakte të bazuar në prova e të cilat janë administruara, e mbi bazën e të cilave është vërtetuar gjendja faktik me rastin e refuzimit të kërkesës respektivisht ankesës së ankueses se e njëjta nuk i ka plotësuar kushtet për fitimin e shtetësisë së R. së Kosovës në pajtim me ligjin, përderisa paditësi para kësaj gjykate ka argumentuar e bashkangjitur prova të mjaftueshme e që këtu e paditura fare nuk i ka administruar dhe vlerësuar. Për këto arsye kjo gjykate ka vlerësuar se njëjta në ri-procedurë obligohet që ti shqyrtoj dhe vlerësoj edhe njëherë pretendimet e ankesës së ankueses në kuptim të bazës së ligjit respektivisht nenit 13.2, *Pjesëtar i diasporës të Republikës së konsiderohet çdo person i cili e ka qëndrimin e ligjshëm dhe të rregullt jashtë Republikës së Kosovës por i cili dëshmon se ka lindur në Republikën e Kosovës dhe se ka lidhje të ngushta familjare dhe ekonomike në Republikën e Kosovës dhe nenit 13.3 Pjesëtar i diasporës të Republikës së Kosovës konsiderohet edhe secili person i cili është pasardhës brenda një gjenerate i personit të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni dhe i cili dëshmon se mban lidhje familjare në Republikën e Kosovës.*

Gjykata si rregull konfliktin administrativ e vendosë në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga vendimi i goditur me padi, nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike.

Kjo gjykatë konstaton se të metat e cekura si më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në ri-procedurë në afat prej 30 ditësh të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoi të metat e lart cekura duke dhënë arsyetim konkret për pretendimet e kërkuarit se nëse i plotëson kriteret që ti njuhët e drejta në shtetësi të R. së Kosovës si pjesëtar i diasporës në kërkesën e kërkuarit dhe të marrë aktvendim të drejtë e të bazuar në ligj.

Gjykata e obligon të paditurën që konform nenit 65 të LKA-së, *“Kur gjykata anulon aktin kundër të cilit ka filluar konflikti administrativ, lënda kthehet në gjendjen në të cilin ishte para se të ishte nxjerrë akti i anuluar dhe në vend të aktit të anuluar administrativ të nxirret një tjetër akt dhe jo më vonë se brenda tridhjetë (30) ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi”.*

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti për Çështje Administrative**  
**A.nr.1900/18, dt.04.10.2018,**

Sekretare juridike  
Kaltrina Çitaku

Gj y q t a r e  
Lirije Maksutaj

**KESHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.